



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 62 paragrafi 62.1. pika (d) lidhur me paragrin 63.1.1 të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 08.03.2024 të paraqitur nga Operatori Ekonomik: Zeqir M. Krasniqi B.I. nga Suhareka me emrin tregtar N.T.SH. "Krasniqi", bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik Zeqir M. Krasniqi B.I. nga Suhareka e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës së prokurimit me datën 08.03.2024 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-23-7240-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-016-2-2-1 me titull: "SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS"

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik Zeqir M. Krasniqi B.I. nga Suhareka me datë 08.03.2024 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit B58 për anulim të procedurës së prokurimit nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: "SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS"

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtaur të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 7; 59; 66 dhe 69 të LPP-s. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime te shkeljes së LPP-s, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim:

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues, është cekur se Me datë: 07.03.2024, pas një procesi maratonik të vlerësimit dhe në kundërshtim me të gjitha afatet kohore të përcaktuara në LPP në nenin 59, AK ka publikuar vendimin me të cilin ka anuluar procedurën e prokurimit duke dhënë arsyeshmërinë së asnjëri nga OE nuk ka përbushur kërkesat e FDT-së. Fillimisht ë RIVLERËSIMI është bërë duke mos respektuar Vendimin e OSHP-

së nr. OSHP: 2023/0676 të datës: 18.12.2023. AK Komuna Mamushë, ne Letrën standarde të datës 07.03.2024, me të cilën na ka eliminuar neve si OE ka bërë dy shkelje të LPP-së: 1. Në arsyen e I-rë thotë që ne jemi eliminuar sepse në përshkrim të çmimeve pjesa B, pozicioni nr. 219 nuk kemi vendosur çnim për Veturën TOYOTA RAW4 4x4. Kjo nuk qëndron fare sepse në këtë pozicion vetë ju si AK keni vendosur N/A, dhe në të njëjtin vendim keni cekur që pozicionet të cilat janë shënuar me N/A nuk keni nevojë me vendosë çmime. Pra ju qëllimisht na keni eliminuar për një pozicion për të cilin keni thënë mos vendos çmime (N/A).

Fillimi është duhet të sqarojmë që O.E. ankues në kërkesën për rishqyrtim ka cekur shumë të pa vërteta duke u munduar që ta paraqes Autoritetin Kontraktues si jo transparent dhe diskriminues. E tere deklarata e tyre bazohet nëakuza të pa baza dhe në të pa vërteta duke fantazuar gjëra të pa kuptimita për ne.

Në kërkesën për rishqyrtim O.E. ankues në pikën 5. Njoftimi mbi eliminimin e tenderuesve ka potencuar se nuk është njoftuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktues lidhur me eliminimin e tyre nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, edhe pse me datën 07.03.2024 ka pranuar letrën standarde për eliminimin në të cilën janë cekur arsyet e eliminimit. Më vonë gjatë përshkrimit të rrëthanave O.E. ankues pranon që ka pranuar letrën standarde.

Sa i përket pretendimit të O.E. ankues se i ka vendosur të gjitha çmimet për të gjitha artikujt e kerkuar, duhet të theksojmë që në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, ne si AK në dosje të tenderit tek aneksi I kemi paraparë që: Pjesët janë specifikuar për secilin lloj vture vec e vec nga nr. 1-19 dhe **OE janë të obliguar që të plotësojnë TE GJITHA rubrikat e çmimeve për secilën vture** sipas kategorive te poshtëshënuara përveç atyre të shënuara me (N/A) (Nuk aplikohet).

Komisioni gjatë ri-vlerësimit të tenderit të O.E. ankues ka konstatuar që O.E. tek pozicioni 219 pjesa B të çmimores për TOYOTA RAW 4X4, 2.0 Benzinë viti i prodhimit 2006, nuk ka vendosur fare çmim edhe pse në këtë kolonë nuk e ka pasur shenjën (N/A) (Nuk aplikohet).

Operatori Ekonomik ankues më tej ka pretenduar që në kolonën në fjalë ka qenë shenja N/A dhe ka cekur shiko foton, mirëpo në foto ka bashkangjitur vetëm gjysmën e dokumentit me qëllim që të manipuloj me dokumentin në fjalë duke u munduar që gabimin që e ka bërë ta mshef në mënyrë që mos të shihet gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

Pasi analizuam dokumentet e tenderit (përshkrimin e çmimit) të bashkangjitur në e-prokurim vërtetuam që komisioni vlerësues me të drejtë kishte konstatuar që O.E. ankues nuk kishte vendosur fare çmim në pozicionin 219 të pjesës B.

Një gjë e tillë mund të vërtetohet tek përshkrimi i çmimit i ngarkuar në platformën elektronike si dhe tek përshkrimi i çmimit i dorëzuar nga O.E. ankues. Shih më poshtë përshkrimin e çmimit.

Kërkesa në përshkrimin e çmimit nga Autoriteti Kontraktues shih pozicionin 219 të pjesës B i shënuar me shigjetë

229	211	Rrethe nesërave	copi	1															1 0.00	1 0.00	
230	211	Kontrollori i ventilatoreve	copi	1				N/A		N/A	N/A	N/A							N/A	1 0.00	1 0.00
231	211	Automatë rekuperit për ndërmes Automallk	copi	1	N/A	1 0.00	1 0.00														
232	220	Materiulli	copi	1	N/A	1 0.00	1 0.00														
233	221	Regulator i gasit (Elektronik)	copi	1	N/A	1 0.00	1 0.00														
234	B - gjithsejt (1-220):																			1 0.00	1 0.00

Pjesa ku O.E. ankues Zeqir Krasniqi B.I. nuk ka dhënë fare çmim në pozicionin 219 të pjesës B, shih pozicionin e shënuar me shigjetë

	Ridje e mësimave	zgjedh	1	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 29.00	€ 1.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 20.00	€ 249.00	€ 49.00
217	Kontrollues i vlerësimeve	zgjedh	1	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	N/A	€ 1.00	N/A	N/A	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 14.00	€ 2.00
218	Kontrollues i vlerësimeve	zgjedh	1	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	N/A	€ 1.00	N/A	N/A	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	N/A	N/A
219	Automat i rikonverzit për indikues Automatik	zgjedh	1	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	€ 2.00	€ 0.40
220	Mata e ligej	zgjedh	1	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	€ 0.00	€ 0.00
221	Regulator i gasit (Elektronik)	zgjedh	1	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	€ 0.00	€ 0.00

Pra sikur shihet më lartë ky pretendim është i pa bazë dhe O.E. ankues mundohet që të arsyetoj gabimet e veta me fakte të pa baza dhe të pa vërteta.

Ndërsa sa i përket pretendimit se përsë është analizuar çmimorja kur O.E. ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm duhet të sqarojmë që Komisioni Vlerësues ka të drejtë të analizoj, vlerësoj dhe krahasoj të gjithë tenderët e pranuar në mënyrë që të vlerësoj se a kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat formale administrative, kërkesat e pranueshmërisë, kërkesat teknike si dhe përshkrimin e çmimit në mënyrë që të siguroj që nuk ka gabime teknik gjatë kalkulimit si dhe të shikoj se a janë vendosur çmimet për të gjithë artikujt sikur është shpjeguar tek dosja e tenderit.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne, të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi, kemi zbatuar procedurën e hapur për prokurimin në fjalë të cilën e kemi udhëhequr në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe ne kemi qenë transparent duke ia ofruar qasjen e pa penguar dhe në kohën më të shpejtë të mundur, për të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar. Nga procesverbali i qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi shihet se përfaqësuesi i O.E. ankues z. Zeqir Krasniqi nuk ka pasur asnje vërejtje në lidhje me qasjen, gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në uebfaqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të Rregullores për prokurimin publik 001/2022 të cilat parashohin:

Citat: "Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- Konkurenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.

- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjtë nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së, me arsyetimin që ne si Autoritet Kontraktues po e shantazhojmë duke kërkuar sqarime se si ka ndodhur që të tërhiqet nga marrëveshja ndërmjetësuesi për larje të automjeteve.

Me datën 15.08.2023 përmes letrës standarde B47 për sqarimin e tenderit kemi kërkuar nga ana e O.E. ankues sqarimin si në vijim:

Në dosjen e tenderit Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE tË Tenderit (FDT) në nenin 9.1 & 9.2 pika 1. Kërkesat mbi mundësitet tekniqe dhe/ose profesionale, është kërkuar si vijon:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Operatori Ekonomik duhet të posedoj autolarje jo më larg se 5 (pesë) km nga territori i Mamushës ose marrëveshje me ndonjë autolarje brenda distancës së kërkuar më lartë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklarata për vendin e autolarjes, në rastë të marrveshjes, marrëveshja orgjinale ose kopja e noterizuar për larjen e automjeteve.

Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të tenderit në fjalë, konkretisht ofertës tuaj, ka konstatuar që ju si O.E keni dorëzuar 1 (një) parakontrat të cilën e keni bërë me O.E “DIMI”SHPK ku në atë parakontrat nuk keni cekur qëllimin e marrveshjes lidhur me kërkesën e AK-s, por keni dorëzuar një

parakontrat ku në të keni cekur vetëm për mundësin e shfrytëzimit të hapsirave të O.E “DIMI”SHPK,

Gjithashtu ju si O.E nuk keni dhanë një deklaratë për vendin në të cilën gjendet autolarja ku si kërkesa eshte cekur se nuk duhet te jetë më larg se 5(pesë) km nga teritori i Mamushës ose 1 (një) marveshje me ndonjë autolarje brenda distancës së kërkuar më lartë.

Në bazë të nenit 10 të udhëzuesit nr .001/2023 si dhe bazuar në nenin 69 të LPP-S, kërkojmë nga ana juaj të na sjellni një sqarim lidhur me kontratën në fjalë deri në afatin e paraparë.

Duke u bazuar në nenin 59 të LPP-ës si dhe nenin 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 të Prokurimit Publik – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit te tenderëve me qëllim te vlerësimit të drejtë të tenderit tuaj, kërkojmë që të na jepni sqarime në lidhje me dëshmin e lartë cekur.

Nga ana e O.E. ankues me datën 17.08.2023 kemi marrë përgjigje në kërkesën për sqarimin tonë sipas së cilës ka deklaruar Citat: “1. Marveshje qe kemi bere me DIMI SHPK eshte shfrytzimi hapsires se biznesit nese jemi fitues i kontratës ne kemi deklaruar qe do te bejme një aneks Kontrat Ne Hapsiren qe eshte permendur aty egziston AUTO LARJE qe eshte kerkuar nga AK ne Dosjen e Tenderit ku dhe lokacionin mund te gjeni me poshtë dhe komisioni mund te vizitoj per verifikim e AUTO Larjes dhe eshte vertetuar me foto” dhe si dëshmi keni dorëzuar disa foto të vendit të autolarjes.

Ndërsa sa i përket deklaratës për vendin e autolarjes jeni përgjigjur si vijon: 2. Deklarat per vendin e Autolarjes eshte se gjendet ne Fshatin Studenqan te SUHAREKES ku fshati eshte 4.5 km larg Mamuses , ndersa DIMI SHPK sipas kriterit te kerkuar ne DosjenTenderit (Jo me larg se 5km nga Teritori MAMUSES) eshte vetem 4.8KM (4800m) larg teritorit te MAMUSES qe është llogaritur nga hyrja e qytetit dhe perfshin teritorin e MAMUSHES dhe vertatuar me foto” dhe si dëshmi keni dorëzuar disa foto.



Pasi kemi marrë sqarimin e O.E. ankues, komisioni vlerësues ka llogaritur si të përgjegjshme ofertën e tyre por për shkak se ka dorëzuar ofertën me çmim më të lartë se të gjithë O.E. pjesëmarrës, tenderi i është llogaritur si tender i pa suksesshëm.

Mirëpo me datën 03.10.2023 Operatori Ekonomik “DIMI”SHPK për të cilin O.E ankues ka deklaruar se posedon marrëveshje për autolarje, ka dorëzuar tek zyra e prokurimit “Njoftimin” me nr të protokollit 02 Nr. 079-23 në të cilin ndër të tjera ka cekur se: Citat “Kompania Zeqir M. Krasniqi B.I. (N.T.SH. Krasniqi) me numër unik identifikues 810634198 tenderues si në tenderin e sipershënuar, gjegjësisht pronari i kompanisë ka ardhur në zyre e biznesit ku ne ushtrojmë veprimtarinë RENT A CAR në fshatin Studenqan dhe na ka kërkuar të lidhim Para Kontratë për shfrytëzimin e hapësirave të biznesit tim për konkurrim në tender. Është e vërtetë që unë e kam firmosur atë Para Kontratë dhe në lidhje me atë Para Kontratë ju njoftoj se:

1. Mua nuk më është bërë me dijeni se duhet të pastroj vetura (Autolarje) për automjetet e K. Mamushë dhe se askund në Para Kontratë nuk ceket se duhet ti pastroj ato vetura. Gjithashtu ju njoftoj se në Certifikatën e Biznesit (Informatori i Biznesit) nuk figuron dhe nuk jam i licencuar për Autolarje (pastrim veturash).
2. Edhe nëse shpallet fitues kompania ne fjalë, unë nuk e lejoj që Automjetet e Komunës Mamushë të pastrohen në Autolarjen time sepse atë Autolarje e përdor vetëm për pastrimin e veturave Rent a Car të myja e jo të tjerëve, sepse nuk kam biznes për Autolarje.

3. Mendoj se nëse është fjala për shfrytëzim të hapësirave të Biznesit tim për Autolarje, jam vënë në lajthitje nga Kompania tenderuese respektivisht nga pronari i saj” Fund i citatit.

Bashkangjitur më poshtë gjeni njoftimin e drejtuar Komunës së Mamushës e protokolluar me numër 02 Nr. 079-23

 "RENT A CAR DIMI" SH.P.K. Studenqan K. Suharekë 049-107-885	 Gjil - Hyrëse - Uzaqës - Incoming 02 No.Nr. 079-23 TreguIDL 03.10.2023
<p>Data: 29.09.2023</p> <p>Për: Komuna e Mamushës</p> <p>Drejtuar: Zyra e Prokurimit</p> <p>Nga: "RENT A CAR DIMI" SH.P.K. – Niazi Gega, Drejtor</p> <p>Lënda: Sqarim në lidhje me tenderimin</p> <p>Tenderi: SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS</p> <p>Nr. i prokurimi 626-23-7240-2-2-1</p>	
NJOFTIM	
<p>Të nderuar,</p> <p>I drejtohem Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushës, në lidhje me tenderin me titull: SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS, me numër prokurimi: 626-23-7240-2-2-1 dhe Nr i brendshëm: 626-23-016-2-2-1.</p> <p>Kompania ZEQJR M. KRASNIQI B.I. (N.T.SH. KRASNIQI) me numër unik identifikues 810634198, tenderues si në tenderin e sipershënuar, gjegjësisht pronari i kompanisë ka ardhur në zyre të biznesit ku ne e ushtrojmë veprimitarinë RENT A CAR në fshatin Studenqan dhe na ka kërkuar të lindhim Para Kontratë për shfrytëzimin e hapësirave të biznesit tim për konkurrim në tender. Është e vërtetë që unë e kam firmosur atë Para Kontratë dhe në lidhje me atë Para Kontratë ju njoftoj se:</p> <ol style="list-style-type: none"> Mua nuk më është bërë më dijeni se duhet të pastroj vetura (Autolarje) për automjetet e K. Mamushë dhe se askund në Para Kontratë nuk ceket se duhet ti pastroj ato vetura. Gjithashtu ju njoftoj se në Certifikaten e Biznesit (Informatori i Biznesit) nuk figuron dhe nuk jam i licencuar për Autolarje (pastrim veturash). Edhe nëse shpallet fitues kompania ne fjalë, unë nuk e lejoj që Automjetet e Komunës Mamushë të pastrohen në Autolarjen time sepse atë Autolarje e përdor vetëm për pastrimin e veturave Rent a Car të miaj, e jo të tjerëve, sepse nuk kam biznes për Autolarje. Mendoj se nëse është fjala për shfrytëzim të hapsirave të Biznesit tim për Autolarje, jam vënë lajthitje nga Kompania tenderuese respektivisht nga pronari i saj. <p>Sinqerisht</p> <p style="text-align: right;">"RENT A CAR DIMI" SH.P.K. Niazi Gega, Drejtor <i>Falem-B</i></p> <p style="text-align: right;">  RENT A CAR DIMI <small>Studenqan, Kukës, Shqipëri</small> </p>	

Bazuar në atë që u tha më lartë konstatohet se pasi që O.E DIMI SHPK thotë se jam lajthitur lidhur me para-kontratën e lidhur me Zeqir Krasniqi B.I dhe deklaron se Automjetet e KK Mamushë nuk do ti laj dhe pasi qe autolarjen e ka vetëm për automjetet personale te Renta Car, O.E. ankues nuk ka një pikë për larjen e automjeteve jo më larg se 5 (pesë) km nga territori i Mamushës sikur është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë andaj edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjisacionit të Prokurimit Publik, për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase dhe më ekonomike. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s dhe është marrë për bazë parimi i shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike, duke u kujdesur që të marrim vlerën për paranë. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetet e kontraktuese në Republikën e Kosovës. Andaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë. Ndërsa O.E. ankues ka ofruar çmimin më të lartë se O.E. tjere pjesëmarrës, si dhe ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm, është për tu habitur pretendimi se janë shkelur këto dispozita, por shihet qartë që këto pretendime janë paraqitur pa kurrfarë fakti apo prove.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 08.03.2024

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtoj ankesë pranë **Organit Shqyrties të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.